

VENDIM
Nr.446, datë 13.7.2007

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.881, DATË 20.12.2006 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE PËR FUNKSIONET DREJTUESE
DHE PËR STRUKTURËN E NIVELET E PAGAVE NË MINISTRINË E PUNËVE TË
JASHTME”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 18 e 29 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, të nenit 45 të ligjit nr.9095, datë 3.7.2003 “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë” dhe të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lidhja nr.1, e përmendur në pikën 1 të vendimin nr.881, datë 20.12.2006 të Këshillit të Ministrave, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Efektet financiare për vitin 2007, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e planifikuara për rritjen e pagave, sipas ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2007.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr. 1

POZICIONI DREJTUES	GRADA DIPLOMATIKE	PAGA MUJORE			
		PAGA INDIVIDUALE (PAGA BAZE)			SHTESA PER GRADE
	<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>5</i>
		Paga e grupit (PG) leke	Shtesa vjetore per Vjetersi (SHV)	Shtesa per Kualifikim (SHK) leke	Shtesa per Pozicion (SHP) leke
Sekretar i Përgjithshëm	Ambasador	10.050	2%	0	110.900
Drejtor i Përgjithshëm	Minister Fuqiplote. Minister Keshilltar. Konsull i Përgjithshëm.	10.050	2%	0	100.500
Drejtor	Keshilltar.	10.050	2%	0	84.000
Përgjegjës Sektori	Sekretar i Pare. Konsull.	10.050	2%	0	65.000
	Sekretar i Dytë. Zevendes konsull.	10.050	2%	0	49.000
	Sekretar i Tretë. Agjent Konsullor.	10.050	2%	0	37.450
	Atashe	10.050	2%	0	25.850